DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON PRIVATIZATION AGENCY RELATED MATTERS	POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA O PITANJIMA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU AGENCIJU ZA PRIVATIZACIJU

AC-I-16-0243

Në ankesën e

Ankuesi në shkallën e I-rë dhe të II-të

Xh. B, Podujevë

Përfaqësuar nga **Avokat V.H**,Prishtinë

kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. 'Ilir Konushefci' nr. 8, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr. sc. Sahit Sylejmani, Kryetar i Dhomës së Posaçme, gjyqtar kryesues, Gertraud Marx Leitenberger, Ondrej Pridal, Ilmi Bajrami dhe Sabri Halili gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e ankuesit të paraqitur kundër Aktgjykimit të gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS, C-IV-13-0346 të datës 22 shtator 206, në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 08 dhjetor 2016, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. **Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar,**
2. **Vërtetohet Aktgjykimi i gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS, C-IV-13-0346 të**

datës 22 shtator 2016. Ndryshohet pika II e dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar, me fjalinë vijuese "e paditura –AKP, është e obliguar që ta marr në konsideratë ankesën e ankuesit Xh. B për kompensimin e mallrave të paguara(3000 copa blloka) e të pa dorëzuara nga NSH-ja 19 "Q" në Podujevë, në shumë prej 1.200,00 Euro dhe kamatën ligjore prej 120 euro, në procedurën e likuidimit, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj."

3. **Obligohet ankuesi të paguajë taksën gjyqësore për procedurën ankimore në shumë prej 100 euro.**

<u>Rrethanat faktike dhe procedurale:</u>

Me datë 25 mars 2013, ankuesi ka dorëzuar një ankesë të afatshme në DHPGJS kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr. PRN028-0158 të datës 21 shkurt 2013, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e tij për kompensim monetar për parapagim të mallrave (blloka) të cilat nuk i janë dorëzuar atij nga ana e NSH-së 19"," Q", në Podujevë (në likuidim), dhe për këtë ka kërkuar shumën prej 1.200,00 euro. Në ankesë ankuesi ka pohuar se NSH-ja "19"," Q" në Podujevë asnjëherë nuk ia ka dërguar 3000 copë blloka të cilat i kishte paguar dhe këtë e dëshmon me faturën nr. 4844 të datës 04.10.1989. Ankuesi po ashtu pohon në ankesën e tij se ai kishte dorëzuar një padi për të marrë kompensimin e cekur edhe në Gjykatën Komunale në Podujevë me datë 14 qershor 1993, por që rasti nuk është vendosë.

Me datë 22 shtator 2016, gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-13-0346, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e ankuesit dhe e ka shfuqizuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së PRN028-0158 të datës 21 shkurt 2013, si dhe e ka obliguar të paditurën që në emër të kompensimit për parapagim të mallrave (bllokave) të cilat nuk janë dorëzuar ankuesit, ti paguajë shumën prej 1.200,00 euro dhe 120 euro në emër të kamatës ligjore, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga

plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi. Gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara i Kolegjit të Specializuar, në Aktgjykimin e ankimuar ka konstatuar se vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit është në kundërshtim me arsyetimin, është i pakuptueshëm, dhe nuk mban arsye të qëndrueshme në të cilat ai është i bazuar. Për më tepër gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara i Kolegjit të Specializuar ka konstatuar se në bazë të provave të shqyrtuara është vërtetuar se paditësi i kishte paguar 3000 copë blloka në emër të NSH "19"," Q", në Podujevë, dhe për këtë NSH-ja i kishte lëshuar faturën ankuesit me numër 4844 të datës 04.10.1989, dhe ky mall asnjëherë nuk i ishte dorëzuar ankuesit. Tutje gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara i Kolegjit të Specializuar ka konstatuar se paditësi me datën 14 qershor 1993 e kishte dorëzuar një padi për kompensim për mos marrjen e mallit të përmendur edhe në Gjykatën Komunale në Podujevë, dhe kjo padi asnjëherë nuk ishte zgjidhur në merita. Gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara i Kolegjit të Specializuar ka konstatuar se pasi që ka filluar procedura e likuidimit të NSH-së së cekur, paditësi në afatin ligjor i është drejtuar me kërkesë Autoritetit të Likuidimit për kompensimin e shumës së të hollave në vlerë prej 1.200,00 euro. Autoriteti i Likuidimit kërkesën e paditësit pa të drejtë dhe pa ndonjë arsye të bazuar e kishte refuzuar. Gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara i Kolegjit të Specializuar në Aktgjykimin e ankimuar ka vlerësuar se është e pabazuar mbrojtja e AKP-së, se kërkesa e ankuesit është parashkruar, kjo për faktin se paditësi me datë 14 qershor 1993 e kishte dorëzuar një padi për kompensim në Gjykatën Komunale në Podujevë dhe me këtë e ka ndërprerë parashkrimin andaj nuk mund të bëhet fjalë për parashkrim të kërkesës. Gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara i Kolegjit të Specializuar ka konstatuar se shuma e kërkuar fillimisht prej 1.200,00 euro nuk është kontestuese në mes palëve dhe këtë shumë e kishte refuzuar mbi bazë të parashkrimit Autoriteti i Likuidimit me vendimin e ankimuar, dhe të cilën shumë AKP-ja nuk e ka kundërshtuar me parashtresën e saj të datës 15 prill 2016, kur ishte përgjigjur dhe kishte paraqitur vërejtjet në ekspertizën financiare të dorëzuar nga ankuesi. Gjykata e Shkallës së parë tutje ka arsyetuar se shuma prej 3.390,78 euro sa përcakton ekspertiza financiare e dorëzuar nga ankuesi nuk është pranuar nga ana e Gjykatës, pasi që ekspertizë të tillë mund të bëjë vetëm eksperti i caktuar

nga ana e Gjykatës e që në këtë rast këtë nuk e ka bërë Gjykata. Gjithashtu pranimi i kësaj shume të cekur në ekspertizë do të përbënte ndryshim të padisë shumës fillestare të kërkuar nga paditësi , që në këtë fazë të procedurës kjo nuk mund të pranohet.

Me datë 27 tetor 2016, paditësi (në tekstin e mëtejmë ankuesi) ka dorëzuar një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-IV-13-0346 të datës 22 shtator 2016, për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave materiale, dhe me ankesë ka kërkuar që Aktgjykimi i ankimuar gjyqtarit të ndryshohet, ashtu që paditësit t'ia mundësojë kompensimin prej 1.200,00 euro dhe 10% kamatë ligjore, prej momentit kur paditësi e ka dorëzuar padinë në Gjykatën Komunale në Podujevë me datë 14.06.1993 e deri me likuidimin e NSH-së me datë 24.08.2005. Rrjedhimisht nga përmbajtja e ankesës shihet se ankuesi e ka kërkuar që kamata ligjore të llogaritet nga data 14.06.1993 kur ai ka dorëzuar padinë në Gjykatën Komunale në Podujevë. Ankuesi bashkë me ankesë ka dorëzuar në DHPGJS një autorizim të ri për Avokatin V. H. nga P dhe ka dorëzuar një dokument noterial LRP.nr. 20541/16 të datës 21.10.2016, me të cilin dokument dëshmohet se ankuesi e ka revokuar autorizimin e avokatit paraprak të tij, M. Sh. nga P.

Me datë 03 nëntor 2016, Kolegji i Apelit ka lëshuar Urdhër me të cilin ankesa e ankuesit i është dërguar të paditurës për të dhënë përgjigje në ankesë. AKP-ja Urdhrin e ka pranuar me datë 04 nëntor 2016.

Me datë 14 nëntor 2016, e paditura e dorëzon një parashtresë në DHPGJS dhe i përgjigjet ankesës së paditësit. E paditura kërkon nga Kolegji i Apelit që të refuzohet ankesa si e pabazuara dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj. Për më tepër në këtë parashtresë AKP-ja ka pohuar se e kundërshton pretendimin ankimore të ankuesit që llogaritja e afatit për kamatën ligjore të kërkuar të bëhet nga data 14.06.1993 dhe pretendimi i ankuesit se mund

të kërkoj kompensim në emër të kamatës mbi 10% për shumën prej 1.200,00 euro është i pabazuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e pranueshme por e pabazuar.
Në bazë të nenit 64.1 të Shtojcës së Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 04/L-033 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Shtojca), Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Me Aktgjykimin e ankimuar gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara i Kolegjit të Specializuar, duke aprovuar ankesën e ankuesit e ka shfuqizuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit nr. PRN028/0158 të datës 21 shkurt 2013, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e paditësit që ti kompensohet shuma monetare prej 1.200,00 euro, për 3000 copë blloka të paguara e të pa dorëzuara nga ana e NSH-së "19"," Q" në Podujevë.

Me Aktgjykimin e ankimuar gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara i Kolegjit të Specializuar, e ka obliguar AKP-në t'ia paguajë shumën prej 1.200,00 euro dhe 120 euro në emër të kamatës ligjore paditësit dhe këtë në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e Aktgjykimit.

Nga përmbajtja e ankesës së ankuesit të paraqitur ndaj Aktgjykimit të gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara shihet se ankuesi e konteston këtë Aktgjykim vetëm sa i përket kamatës ligjore të caktuar, përkatësisht vetëm për afatin prej kur

sipas tij duhet filluar llogaritja e kamatës ligjore, ndërsa në aspekte tjera ankuesi nuk e konteston këtë Aktgjykim.

Në bazë të nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit ***"3. Të gjitha kërkesat e bëra ndaj ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë përqind) të shumës themelore."*** Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara i Kolegjit të Specializuar, saktë e kishte llogaritur shumën e kamatës ligjore të caktuar në pikën **II** të Aktgjykimit të ankimuar, andaj pretendimi ankimor i ankuesit se kamata ligjore duhet të llogaritet nga data 14.06.1993 kur e kishte dorëzuar padinë në Gjykatën Komunale në Podujevë, nuk është i saktë.

Në bazë të dispozitës së cekur ligjore të Shtojcës së ligjit të AKP-së që është ligj special në raport me dispozitat e ligjeve tjera që rregullojnë këtë çështje, kamata ligjore e lejuar nuk mund të tejkalojë 10% të shumës themelore.

Në këtë rast kompensimi i lejuar në bazë të Aktgjykimit të ankimuar është 1.200,00 euro dhe kamata për këtë shumë në dispozitës së cekur është vetëm 120 euro, do të thotë 10% i shumës së aprovuar të kompensimit. Andaj ankuesi nuk mund të pretendoj të marrë shumë më të lartë të kamatës për kompensimin e lejuar dhe as të pretendoj se kjo kamat duhet llogaritur nga data 14.06.1993.

Nga këto arsye ankesa e ankuesit duhet të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara i Kolegjit të Specializuar.

Duke qenë se ankuesi me ankesën e tij nuk ka kontestuar aspektet tjera të Aktgjykimit, Kolegji i Apelit nuk do të jap vlerësime ligjore për saktësinë e gjetjeve faktike dhe arsyerave ligjore të aprovimit të padisë, e në të cilat bazohet Aktgjykimi i ankimuar.

Kolegji i Apelit e ka ndryshuar pikën II të dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar dhe e paditura –AKP, është e obliguar që ta marr në konsideratë padinë e paditësit Xh. B për kompensimin e mallrave të paguara(3000 copa blloka) e të pa dorëzuara nga NSH-ja "19"," Q" në Podujevë, në shumë prej 1.200,00 Euro dhe kamatën ligjore prej 120 euro, në procedurën e likuidimit, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj.

Mbi bazën e këtyre arsyeve e në bazë të nenit 10.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore:

Ankuesi obligohet të paguajë taksën gjyqësore për procedurën ankimore në shumë prej 100 euro, bazuar në vendimin e KGJK-së për taksa gjyqësore nr. 25 të datës 05 mars 2014, i aplikueshëm nga data 27 mars 2014.

Mr. sc. Sahit Sylejmani
Gjyqtar Kryesues

_____